



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Kosova**  
**Cumhuriyeti**



**Komuna e Prizrenit**  
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

### ***Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit***

*Prizren, 04.05.2022*

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Prizrenit, u bën:

### ***THIRRJE PUBLIKE***

1. Për të gjitha Organizatat Jo-Qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës dhe individët që veprojnë në Komunën e Prizrenit, programi i punës i cili është i fokusuar në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, dhe që përfshijnë aktivitete të realizuara në Komunën e Prizrenit, të aplikojnë për mbështetje financiare:

### ***Në fushën e kulturës:***

#### ***LOT: I***

U dedikohet organizatave kulturore që veprojnë në Komunën e Prizrenit dhe që operojnë gjatë tërë vitit dhe kanë aktivitete kulturore të nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar, të cilat kontribuojnë në mënyrë të dëshmuar në zhvillimin kulturor, ekonomik dhe shoqëror, të Komunës së Prizrenit. Organizatat kulturore që posedojnë struktura të qarta qeverisëse, si dhe strategji afatmesme organizative dhe programore.

Synimet specifike të LOT 1:

- a) Përkrahja e programit vjetor të organizatave;
- b) Promovimi kulturor të Komunës së Prizrenit;
- c) Krijimi i produkteve të reja kulturore;
- d) Zhvillimi i turizmit kulturor;
- e) Ofrimi i programeve edukative për publikun e Komunës së Prizrenit;
- f) Krijimi i përmbajtjes për periferinë e qytetit , zonat rurale dhe grupet e nën përfaqësuar;
- d) Ndërtimi i partneriteteve rajonale dhe ndërkombëtare.

Kjo kategori e organizatave, përveç dokumenteve të kërkuara nga të gjitha organizatat, duhet të ofrojnë edhe:

- Raportin vjetor të punës 2021;
- Strategjinë e Organizatës;
- Strukturën Organizative – Organogramin.

## ***LOT: II***

U dedikohet organizatave kulturore dhe individëve që zhvillojnë dhe organizojnë aktivitete të ndryshme kulturore dhe festivale me karakter afatshkurtër në nivelin komunal apo rajonal.

Aktivitete që kanë për qëllim pasurimin e kalendarit vjetor kulturor të qytetit, aktivitete që kontribuojnë në shumëllojshmërinë artistike dhe aktivitete që begatojnë jetën e komuniteteve në fushën e kulturës.

Synimet specifike të LOT II:

- Manifestime: Shënimi i datave historike, shënimi i festave kombëtare dhe ndërkombëtare dhe shënimi i datave të tjera me rëndësi në Komunën e Prizrenit;
- Mbështetja e aktiviteteve vjetore të organizatave dhe operatorëve kulturor;
- Muzikë: Kompozimi i veprës së re, audio incizim, koncert, fuqizimi i muzikantëve të rinj;
- Shoqëritë Kulturore - Artistike: Mbështetje e aktiviteteve në promovimin e krijimtarisë lokale artistike, shënimi i datave historike kombëtare dhe ndërkombëtare dhe datave tjera me rëndësi për Komunën e Prizrenit;
- Teatër: Prodhimi i shfaqjes, promovimi dhe pjesëmarrje e shfaqjes në festivale kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Kinematografi: Film dokumentar, film i shkurtër, fuqizim i kinematografëve të rinj në ruajtjen e traditave lokale dhe trashëgimisë kulturore të Komunës së Prizrenit;
- Art Vizual - Figurativ: Krijimi i veprës së re, fuqizimi i artistëve të rinj, ekspozita të organizuara në hapësira publike;
- Mbështetja e aktiviteteve kulturore të personave me nevoja të veçanta.

## ***Në fushën e rinisë:***

### ***Synimet specifike:***

- Mbështetja e aktiviteteve rinore, promovimi i vullnetarizmit, integrimi i grupeve rinore dhe atyre të marginalizuara, mbështetja e ideve-projekteve si dhe promovimi i talentëve;
- Edukimi jo formal: Trajnime, Punëtori, Debate, Hulumtime, për të rinjtë që ndikojnë drejtpërsëdrejti në nxitjen e aktiviteteve rinore dhe luftimin e dukurive negative tek të rinjtë;
- Mbështetja për përfshirjen sociale dhe organizimi i ngjarjeve promovuese dhe rekreative;
- Mbështetja e aktiviteteve rinore të personave me nevoja të veçanta.

## ***Në fushën e sportit:***

### ***Lot I***

U dedikohet subjekteve apo klubeve të Komunës së Prizrenit, që operojnë gjatë gjithë vitit dhe që posedojnë struktura të qarta udhëheqëse si dhe strategji organizative dhe programore.

- a) Të kenë në gjirin e tyre ekipin e seniorëve, të femrave, juniorëve, kadetëve dhe pionierëve;
- b) Të kenë në gjirin e tyre së paku 4 trajner të licencuar nga Federata gjegjëse;
- c) Të kenë traditë të gjatë të veprimtarisë, për çdo dhjetë vjet traditë 5 pikë;
- d) Të kenë në gjirin e tyre së paku 200 sportistë të regjistruar pranë federatës gjegjëse;
- e) Të sjellin dëshmi për rezultatet e tyre në 10 vitet e fundit;
- f) Të aplikojnë me projekt një të një prej fushave të poshtëshënuara.

### ***Lot II***

- a) Të kenë në gjirin e tyre së paku tri ekipe (p.sh. : seniorët, juniorët, kadetët ose pionierët);
- b) Të kenë në gjirin e tyre së paku 2 trajner të licencuar;
- c) Të kenë traditë të gjatë të veprimtarisë, çdo dhjetë vjet traditë 5 pikë;
- d) Të kenë në gjirin e tyre së paku 100 sportistë të regjistruar;
- e) Të sjellin dëshmi për rezultatet e tyre në 5 vitet e fundit;
- f) Të aplikojnë me projekt një të një prej fushave të poshtëshënuara;

### ***Lot III***

- a) Të gjithë të interesuarit tjerë, individë, klube dhe OJQ;
- b) Të aplikojnë me një projekt njëren prej fushave të poshtëshënuara.

#### ***Synimet specifike:***

- Masivizimi i sportit për të rinj, përkrahja e projekteve me qëllim të zhvillimit të aktiviteteve të sportit për të rinj në nivel lokal dhe rajonal;
- Edukimi i të rinjve përmes sportit (projekte edukative për grup-mosha të reja);
- Aktivitete edukative me qëllim të evitimit të dhunës dhe dukurive negative në sportit dhe kultivimi i vlerave fisnike të sportit.

2. Vlerësimi i projekteve do të bëhet nga një komision 5-anëtarësh, të cilët do t'i vlerësojnë projektet në bazë të kriterëve për vlerësim, sipas rregullores MF-NR 04/2017 mbi kriteret dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, dhe rregullores NR.02/2020, të Komunës së Prizrenit, mbi ndarjen e subvencioneve.

Kriteret vlerësuese shtesë janë: raporti paraprak narrativ dhe financiar, për projektin paraprak dëshmia e njoftimit të monitoruesit në DKRS, projekt-propozimet që kanë bartëse të projekti gruan.

3. Aplikimi i OJQ-ve dhe individëve do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes si në vijim:

Formulari i Aplikacionit për projekt/programin (e shtypur );

Formulari i deklaratës për mungesë të financimit të dyfishtë (e shtypur);

Dokumenti identifikues;

Certifikata e regjistrimit OJQ;

Dëshmi që nuk ka obligime ndaj ATK-së (për persona juridik) për vitin 2022;

Dëshmi që ka dorëzuar raportin financiar dhe narrativ nga viti paraprak;

Konfirmim nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit (e shtypur).

4. Formulari për aplikim mund të merret në ueb-faqe të Komunës dhe mund të dorëzohen duke filluar nga data **04.05.2022 deri 02.06.2022**. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

5. *Vlera e planifikuar e mbështetjes financiare për OJQ-të nga lëmia e Kulturës :*

- a. Shuma e mbështetjes financiare, që mund të alokohet nga fusha e **kulturës** për projektet **Lot 1**, është **deri në 50.000 €**;
- b. Shuma e mbështetjes financiare, që mund të alokohet nga fusha e **kulturës** për projektet **Lot 2**, është **deri në 30.000 €**;
- c. Shuma e mbështetjes financiare, që mund të alokohet nga fusha e **kulturës** për projektet **Lot 3**, është **deri në 7.000 €**;

*Vlera e planifikuar e mbështetjes financiare për OJQ-të nga lëmia e Sportit :*

- a. Shuma e mbështetjes financiare, që mund të alokohet nga fusha e **sportit** për projektet **Lot 1**, është **deri në 90.000 €**;
- b. Shuma e mbështetjes financiare, që mund të alokohet nga fusha e **sportit** për projektet **Lot 2**, është **deri në 30.000 €**;
- c. Shuma e mbështetjes financiare, që mund të alokohet nga fusha e **sportit** për projektet **Lot 3**, është **deri në 10.000 €**;

*Vlera e planifikuar e mbështetjes financiare për OJQ-të nga lëmia e Rinisë :*

- a) Shuma e mbështetjes financiare, që mund të alokohet nga fusha e **rinisë** për projektet është **deri në 10.000 €**

*Vlera e planifikuar e mbështetjes financiare për Individët nga lëmia e Kulturës, Rinisë dhe Sportit :*

- a) Shuma e mbështetjes financiare për individët, që mund të alokohet nga fusha e **kulturës**, **rinisë** dhe **sportit** është deri **në 3.000 €**.

### ***Kushtet e pergjithëshme për aplikim:***

1. OJQ-të dhe individët në kuadër të kësaj thirrjeje mund të aplikojnë më së shumti me një projekt, për secilën nga fushat e thirrjes.
2. Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të, që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave Jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës.
3. Aplikuesit duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në njërin nga fushat e aplikimit.
4. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Komunës së Prizrenit - Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.
5. Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe apo menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja, ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të paguara, nëse është e aplikueshme.
6. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare të Komunës së Prizrenit.
7. Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen personalisht, në adresën e mëposhtme:  
Komuna e Prizrenit,  
Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit,  
***Sporteli nr.1-2-3-4 në ndërtesën e Komunës,  
20000 Prizren.***
8. Procesi i pranimi, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i komenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara.
9. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

## Vërejtje:

Projektet të cilat nuk i kanë të bashkangjitura dokumentet sipas kërkesës nuk do të merren parasysh nga Komisioni për shqyrtimin e kërkesave.

Shpenzimet e papranueshme përfshijnë: inventari, qiraja për zyre, komunalit si dhe nuk përkrahen projektet e OJQ-ve që mund të kenë ndikim politik, religjioz etj

Komuna e Prizrenit nuk është e detyruar të ndajë të gjithë buxhetin e paraqitur në aplikacion.

Buxheti do të ndahet për projektet kualitative të vlerësuara nga komisioni përkatës.

Me respekt,

Drejtori i DKRS-së  
Adem Morina

---